



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-3086
Nri faqëve Br. stranica No. pages	-86-
Data Datum Date:	27,04,2026
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit- Ured Ministra -Office of the Minister

Nr: 63/IV/2026

Datë: 24/04/2026

Ministri i Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenit 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, shkresën nr.prot. 05 - 3021, datë 23.04.2026, si dhe nenin 5 të Ligjit Nr.08/L-220 për çmimin e produkteve medicinale, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Lista zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale të Bartësve të autorizimit të marketingut dhe/ose përfaqësuesve të tyre - **Versioni 1**.
- II. Afati i vlefshmërisë së çmimeve të produkteve medicinale është i përcaktuar në Listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale e cila është pjesë e këtij vendimi.
- III. Obligohen qarkulluesit me shumicë dhe pakicë që t'i përmbahen çmimeve të produkteve medicinale të përcaktuara në Listen e cila është pjesë e këtij Vendimi.
- IV. Lista Zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale është pjesë e këtij Vendimi dhe e njëjta publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetsisë dhe Agjencisë së Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale.
- V. Ky vendim hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet me datë 1- Maj 2026.

A r s y e t i m i

Bazuar në shkresën nr. prot. 05-3021, datë 23.04.2026, të Komisionit për Përcaktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale, me të cilën është kërkuar miratimi i Listës Zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, pasi janë përfunduar procedurat e ankesave nga Komisioni i Ankesave për Çmimin e Produkteve Medicinale ndaj listave preliminare të çmimeve të produkteve medicinale, të publikuara më datë 05.02.2026 dhe 04.03.2026, si dhe miratimi i çmimeve të deklaruara për herë të parë në afatin janar-shkurt 2026, bazuar në dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr. 08/L-220 për Çmimin e Produkteve Medicinale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Dr. Arben Vitia
Ministër i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- *Zëvendësministrave të MSH-së;*
- *Sekretarit i Përgjithshëm;*
- *UD. Kryeshefit të AKPPM-së;*
- *Z.Edon Muçaj, Kryesues i Komisionit;*
- *Komisionit të ankesave;*
- *Departamentit ligjor;*
- *Arkivit të MSH-së.*